



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm

R A P O R T

Mbi veprimtarinë e
Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm
(SHKB)

Viti 2012

Fjala hyrëse e Ministrit të Brendshëm Z. Flamur NOKA



Lufta kundër korrupsionit, veçanërisht në rradhët e policisë ashtu si dhe në atë të gjyqësorit, është një nga gurët e themeleve për të siguruar një qeverisje të mirë.

E për Qeverinë Shqiptare, Ministrinë e Brendshme e strukturat në varësi të saj, në veçanti për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, kjo ka qenë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga shtyllat kryesore të veprimitarisë së këtij shërbimi.

Policia, në një shtet demokratik, është forca civile e tij, që ka përgjegjësi për të parandaluar dhe zbuluar krimin si dhe për të ruajtur rendin publik.

Mosrespektimi i ligjit nga policia mund të çojë në rritjen e veprimitarisë kriminale, uljen e zbulueshmërisë së tyre si dhe rënien e besimit të publikut ndaj vetë strukturave ligjzbatuese të shtetit.

Tek Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, si një institucion i administratës civile, një Agjenci Mbikqyrëse dhe Strukturë për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit në rradhët e Policisë së Shtetit, do të gjeni aleatin tuaj më të ngushtë, të paanshëm, profesional dhe eficientë në vënien përpara përgjegjësisë ligjore dhe disiplinore të çdo punonjës policie që kryen shkelje ligjore pavarësisht nga grada dhe detyra që ai kryen.

Raporti Vjetor 2012, i SHKB-së, është një dokument që e informon publikun me veprimtarinë e punës 1-vjecare të këtij shërbimi, në përbushje të objektivave dhe detyrave të përcaktuara në Planin Vjetor të Punës, në zbatim të detyrimeve në kuadër të dokumentave strategjikë të hartuara nga qeveria shqiptare në proceset integruese të Shqipërisë në familjen europiane.

Ashtu si dhe vitet e kaluara, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, duke gërshtuar masat proaktive me ato reaktive, veprimtarinë e strukturave të saj hetimore me ato të strukturave inspektuese, duke rritur bashkëpunimin dhe bashkëveprimin brenda vetë strukturave të shërbimit në nivel qëndror e vendor si dhe me strukturat e Policisë së Shtetit, me Prokurorinë, me Shërbimin Informativ Shtetëror, dhe agjenci të tjera ligjzbatuese ka arritur të parandalojë, zbulojë dhe godasë veprimtarinë anti-ligjore dhe kryesisht atë korruptive të kryer nga punonjës të vecantë të Policisë së Shtetit.

Numri i konsiderueshëm i ankesave që publiku ka paraqitur pranë këtij institucioni, tregon për rritjen e besimit të publikut tek personeli i këtij shërbimi, transparenca, profesionalizmi dhe eficaenca në kryerjen e detyrave funksionale që u ka atribuar ligji.

Ministria e Brendshme dhe unë personalisht, do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar këtij shërbimi një mbështetje maksimale në përbushje me sukses të misionit të tij ligjor, por njëkohësisht të garantojmë komunitetit një shërbim policor të përgjegjshëm, efektiv dhe eficient në përputhje me standartet e kërkuara.

Gjej rastin t'ju ftojë të bashkëpunoni me SHKB-në, por edhe me të gjitha strukturat e Ministrisë së Brendshme, në luftën tonë të përbashkët kundër korrupsionit.

**Fjala hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm të SHKB-së
Z. Bashkim SHEHU**



Ky është viti i tretë që Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, harton dhe boton Raportin Vjetor të Punës, një tablo e qartë mbi atë çka ky shërbim ka realizuar dhe mosrealizuar në veprimtarinë e tij gjatë vitit 2012.

Ashtu si dhe vitet e kaluara, SHKB-ja, i gjithë personeli hetues, inspektues dhe i shërbimeve mbështetëse është angazhuar në përmbushjen e objektivave dhe detyrave të përcaktuara në Planin e Punës për vitin 2012.

Por njëkohësisht edhe në zbatimin e detyrimeve që dalin nga Planet e Veprimeve Ndërinstitucionale të hartuara në kuadër të strategjive dhe dokumentave të rëndësishëm për të gjitha institucionet e Shtetit Shqiptar. Konkretisht në:

- Planin e Veprimit 2011 ó 2013, òPër zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparenteò;
- Planit të Veprimit për zbatimin e 12 Rekomandimeve të Opinionit të Komisionit Evropian në kuadrin e proceseve integruese për marrjen e statutit të vendit kandidat për në Bashkimin e Europian;
- Planin e Veprimit të 2011 ó 2013, òPër zbatimin e Strategjisë së Luftës Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore dhe Fëmijeveò.

Gjatë vitit 2012 është vazhduar puna në përmirësimin dhe hartimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të ligjit të SHKB-së, me qëllim arritjen e standardeve të përcaktuara në dy konventat ndërkombëtare në fushën e korrupsionit.

Është miratuar:

- ***Udhëzimi Nr. 39/1, datë 09.04.2012 i Ministrit të Brendshëm “Për kryerjen e Mbikqyrjes së Fshehtë Fizike nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm”.***

Në proces draftimi:

- ***Udhëzimi i përbashkët me Prokurorinë e Përgjithshme për “Masat e vecanta për mbledhjen e të dhënave dhe përdorimin e teknikave të posacme të hetimit në rastet e korrupsionit nga punonjësit e Policisë së Shtetit”;***
- ***Draft-Udhëzimi për Procedurat Standarte të Punës së SHKB-së.***

Veprimtaria e strukturave hetimore të SHKB-së, është fokusuar në rritjen e cilësisë dhe numrit të rasteve të sukseshme të parandalimit, zbulimit dhe goditjes së veprimtarisë korruptive dhe jo vetëm nga punonjës të Policisë së Shtetit. Për të garantuar publikun se askush në Policinë e Shtetit nuk

mund t'ia shmanget përgjegjësisë ligjore nëse ndaj tij, ka dyshime për përfshirje në veprimtari kriminale, strukturat me kompetenca hetimore të SHKB-së, nëpërmjet një bashkëpunimi dhe bashkërendimi të punës midis strukturave në nivel vendor e qëndror, ka arritur të paraqesë pranë organit të Prokurorisë **105** çështje penale për **132** punonjës policie të nivele të ndryshme.

Ajo çka është më rëndësishme të theksojmë është fakti që në të gjitha hetimet e kryera nga strukturat hetimore janë përdorur mjetet dhe metodat speciale të hetimit, ndjekjes së track ó record (gjurmimit të rasteve) dhe delegimit të kompetencave për kryerjen e veprime hetimore procedurale nga prokurori i autorizuar, që asiston punën e shërbimit në çdo rast.

Gjithashtu si rezultat dhe i një bashkëpunimi të ngushtë ndërinstucional, me struktura të Policisë së Shtetit, Njësitë e Përbashkëta Hetimore (Task Forcë) dhe Prokurorisë, gjatë vitit 2012 u arrit të zbulohet dhe goditet veprimtaria kriminale në fushën e trafikun të lëndëve narkotike e shtrirë në qytetet Tiranë, Vorë e Elbasan dhe arrestimi në flagrancë i punonjësit të policisë dhe shtetasve të implikuar, si dhe sekuestrimin në cilësinë e provës materiale të **27.7 kg heroinë, 28 kg përzierje kokaine, 141 kg përzierje heroine, 0.8 gr kokainë; 13.100 Euro; 600.000 lekë te reja; një pistoletë e tipit TT, peshore elektronike dhe mjete te tjera për paketimin e shpërndarjen e lëndës narkotike, 26 celularë te tipeve te ndryshme, 4 automjete etj.**

Duhet të theksojmë dhe një fakt mjaft të rëndësishëm rritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të strukturave hetimore të SHKB-së, për hetimin e çështjeve korruptive dhe jo vetëm, sado të vështira të jenë ato. Kjo ka ardhur si rezultat nga njëra anë i investimeve për blerjen e pajisjeve të teknologjisë së fundit në përdorim nga trupa operationale e SHKB-së dhe nga ana tjetër trajnimi i vazhdueshëm i personelit hetues, falë bashkëpunimit të ngushtë dhe mbështetjes që kemi marrë dhe vazhdojmë të marrim nga partnerët tanë ndërkombëtarë, e në mënyrë të veçantë nga programi ICITAP dhe OSCE.

Veprimtaria inspektuese e realizuar nga strukturat e Drejtorisë së Inspektiveve të SHKB-së. Edhe pse ka vetëm 2 vjet e gjysëm që kjo strukturë është ngritur pranë Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, personeli inspektues i kësaj drejtorie ka arritur nivele të kënaqshme profesionalizmi, efektiviteti dhe efijence në punën e tyre.

Edhe gjatë vitit 2012 ata kanë kryer sipas planit vjetor të punës **17** inspektive, në Drejtorinë e Policive në Qarqe, në Njësitë Rajonale të Policisë Rrugore dhe Drejtorinë Rajonale të Kufirit & Migracionit si dhe **2** inspektive të jashtëzakonshme.

Gjatë inspektiveve është vënë gjithmonë theksi, në evidentimin e problemeve dhe mangësive që hasen në veprimtarinë e përditshme të punës së strukturave të Policisë së Shtetit, me qëllim dhënien e rekomandimeve për menaxherët e lartë të policisë dhe ndërmarrjes prej tyre të masave konkrete për përmirësimin e vazhdueshëm të situatës, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi.

Gjithashtu, mbetet fokus i punës së përditshme të strukturës inspektuese të SHKB-së, mbikqyrja e veprimtarisë së strukturave të policisë, nëse gjatë ushtrimit të kompetencave ligjore janë respektuar dhe do të respektohen liritë dhe të drejtat themelore te individit, të drejta të garantuara nga dokumenti themeltar, Kushteta e Shqipërisë e Aktet ndërkombëtare.

Trajtimi i ankesave të shtetasve, është një tjetër shtyllë e rëndësishme e veprimtarisë së SHKB-së. Kjo pjesë e veprimtarisë së punës sonë është parë gjithmonë nga ana jonë si një detyrim moral që ne kemi ndaj komunitetit, pjesë e të cilit jemi dhe vetë ne, për t'ia garantuar një shërbim policor sa më të përgjegjshëm, efektiv, efijent dhe demokratik në ushtrimin e kompetencave.

Edhe gjatë këtij vitit, pranë Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, kanë ardhur një numër i konsiderueshëm ankesash, nëpërmjet infrastrukturës tashmë të ngritur dhe funksionale nga ana jonë. Kështu ankesat janë marrë nëpërmjet linjës jeshile **0800 90 90**, e-mail, shërbimeve postare, paraqitjes personalisht të shtetasve në zyrat tona në nivel qendror e vendor etj.

Gjatë gjithë procesit të marrjes, shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, jemi përpjekur të jemi sa më objektiv dhe të paanshëm, duke synuar të eidentojmë çdo rast të sjelljeve të këqija apo shkeljes së ligjit nga punonjës policie dhe vënies së tyre përpara përgjegjësisë ligjore apo disiplinore.

Kështu jo në pak raste, ankesat e shtetasve kanë shërbyer si indicje për fillimin e një hetimi penal, konkretisht gjatë vitit 2012, në **12** raste. Gjithashtu falë bashkëpunimit të ngushtë me Drejtorinë e Standarteve të Policisë së Shtetit, për **80** praktika të dërguara nga ana jonë, është filluar ecuria disiplinore dhe janë ndëshkuar me masa disiplinore **70** punonjës policie.

MISIONI YNË

“Është t’i garantojë komunitetit një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara”.

FALËNDERIME

Falënderojmë qytetarët që kanë bashkëpunuar dhe ndihmuar SHKB-në në përmbushjen e misionit të saj ligjor.

Falënderojmë të gjithë punonjësit e SHKB-së, që me përkushtim dhe profesionalizëm punojnë për përmbushjen e objektivave të organizatës sonë.

Falënderojmë punonjësit dhe menaxherët e Policisë së Shtetit, të cilët kanë asistuar SHKB-në për kryerjen e detyrave të saj ligjore.

Shprehim mirënjohje për mbështetjen që na ka dhënë Ministri i Brendshëm në përmbushjen e objektivave strategjike të SHKB-së.

Falënderojmë për bashkëpunimin të gjitha agjencitë e tjera ligjzbatuese.

Falënderojmë të gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë: ICITAP, PAMECA, OSBE dhe TIKA të cilët kanë asistuar nga afër punën tonë duke na këshilluar me praktikat më të mira Euro-Atlantike, si dhe kanë bërë të mundur zhvillimin e një cikli trajnimesh për personelin hetues dhe inspektues të SHKB-së.

Falënderojmë të gjithë ata që japin kontributin e tyre për të luftuar korrupsionin dhe shkeljet e tjera të ligjit në Policinë e Shtetit.

Falënderojmë grupin e punës të cilët hartuan këtë dokument, që është një instrument i rëndësishëm në funksion të trasparencës të punës së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm.

SHKURTIME

KE	Komisioni Evropian
DASH	Departamenti Amerikan i Shtetit
DPQ	Drejtoria e Policisë së Qarkut
NJRPRR	Njësia Rajonale e Policisë Rrugore
DRKM	Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit
GRECO	Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës Kundër Korrupsionit
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Ndhmës së Trajnimit të Hetimit të Krimeve
MB	Ministria e Brendshme
OSBE	Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim Evropian
PAMECA	Misioni i Ndhmës Policore të Komunitetit Evropian për Shqipërinë
PSH	Policia e Shtetit
SHKB	Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm
TIA	Transparenca Ndërkombëtare për Shqipëri
TIKA	Agjencia e Zhvillimit dhe Kooperimit Ndërkombëtare e Turqisë

PASQYRA E LËNDËS

Fjala hyrëse e Ministrit të Brendshëm.....	2
Fjala hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm të SHKB-së.....	3
Falënderime.....	6
Shkurtime.....	7
Organizimi aktual i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm.....	9
Buxheti i vitit 2012 dhe realizimi i tij	9
Trajnimet e personelit	10
Veprimtaria Hetimore.....	13
Trajtimi i ankesave të shtetasve për punonjës të Policisë së Shtetit.....	19
Bashkëpunimi me Drejtorinë e Standardeve Profesionale në PSH.....	21
Veprimtaria e Drejtorisë së Inspektimeve	23
Rekomandime për Policinë e Shtetit	31
Objektiva për SHKB-në.....	32
Si do të matet realizimi i objektivave të SHKB-së.....	33
Si mund të na kontaktoni	34

ORGANIZIMI AKTUAL I SHKB-së

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, është një institucion i administratës publike, strukturë e veçantë e Ministrisë së Brendshme, në varësi të Ministrit të Brendshëm. Është i organizuar në nivel të Drejtorisë së Përgjithshme, me numër të personelit **90** punonjës të ndarë:

- 74 funksione janë personel hetues
- 9 funksione janë personel inspektues
- 7 funksione janë personel për shërbimet mbështetëse.

Shpërndarja aktuale e personelit të shërbimit në bazë të funksioneve të miratuara është bërë në nivel qendror në Departamentin e Hetimit me **34** funksione dhe nivel vendor me **40** funksione, në nivel qendror Drejtoria e Inspektimeve me **9** funksione dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse me **7** funksione.

Personeli i **Departamentit të Hetimit** ka ushtruar kompetencat hetimore me qëllim, *“**ōzbulimin, dokumentimin, goditjen dhe hetimin paraprak të veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit, pavarësisht nga funksioni dhe grada**”*.

Drejtorja e Inspektimeve, ka ushtruar kompetencat për inspektimin e strukturave të Policisë së Shtetit, *“**për përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara, për garantimin e përgjegjshmërisë, efektshmërisë dhe efikasitetit të tyre**”*.

Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse, gjatë këtij viti është përpjekur të menaxhojë sa më mirë burimet njerëzore, buxhetin dhe të sigurojë mbështetjen logjistike të SHKB-së.

BUXHETI I VITIT 2012, REALIZIMI I TIJ

Nr	Artikulli	Plani	Realizimi	Diferenca	Realizimi në %
1.	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	95,922,540	83,187,332	21,488,181	87%
2.	Sig.Shoqërore dhe Shëndetësore	14,735,000	12,204,607	2,530,393	83%
3.	Mallra e shërbime të tjera	17,400,000	14,888,000	2,512,000	86%
4.	Transferime për buxhetet familjare dhe individët	3,600,000	3,310,000	290,000	92%
5.	Investime	3,732,000	3,731,112	888	99%
6.	TOTALI	135,389,540	117,321,051	26,821,462	87%

TRAJNIMET E PERSONELIT

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, prej vitesh asistohet në veprimtarinë e tij nga Programi Ndërkombëtar i Ndhmës së Trajnimit të Hetimit të Krimeve (ICITAP), Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Europian (OSBE), si dhe Agjencia e Zhvillimit dhe Kooperimit Ndërkombëtar e Turqisë (TIKA), nëpërmjet këshillimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të personelit hetues dhe inspektues të shërbimit. Konkretisht gjatë vitit 2012, prej tyre janë organizuar disa trajnime të personelit të SHKB-së si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

1. Trajnimi 1 punonjësi të SHKB-së në ILEA në kursin e ÷Akademisë Ndërkombëtare të Zbatimit të Ligjitë, nga data 7 Janar ó 2 Mars 2012.
2. Trajnimi i 2 punonjësve të SHKB-së në Vushtri, Kosovë, në kursin ÷Sesioni i Dytë i Shkollës së Stafit dhe Komandës së Policisë, nga data 9 janar ó 10 shkurt dhe 27 shkurt ó 30 Mars 2012.
3. Trajnimi i 9 punonjësve të Drejtorisë së Inspektimeve, të SHKB-së, në kursin ÷Inspektimi i avancuar për Kontrollin e Brendshëm, në ambjentet e Qendrës së Arsimit Policor, nga data 18 ó 29 Qershor 2012.



4. Trajnimi i 12 shefa të sektorëve të hetimit në qendër dhe bazë në ÷Kursin e oficerëve madhorë të hetimitë gjatë periudhës 29 Tetor ó 02 Nëntor, organizuar nga ICITAP, në ambjentet e Qendrës së Arsimit Policor.

5. Trajnimi i 2 punonjësve të SHKB-së në kursin e Sesionit të Tretë të Shkollës së Stafit dhe Komandës së Policisë së bashku me 10 punonjës të Policisë së Shtetit, nga data 10 Shtator ó 12 Tetor dhe 28 Tetor ó 30 Nëntor 2012. Ky trajnim është mbështetur nga misioni ICITAP dhe i organizuar nga Universiteti Northwestern, Ilinios, SHBA.



6. Trajnimi i 22 punonjësve të personelit hetues, në ÷Kursin e avancuar të hetimito gjatë periudhës 05 ó 16 nëntor, organizuar nga ICITAP, në drejtimin e 2 trajnuesve nga Britania e Madhe, në ambientet e Qendrës së Arsimit Policor.



7. Trajnimi i personelit të trupës operationale të SHKB-së, me temë ÷Veprimet e agentëve nënmbulimó me katër faza, nga të cilat 2 prej tyre janë kryer në periudhën 24 ó 28 Shtator dhe 19 Nëntor ó 24 Nëntor 2012, dhe 2 të tjerat do të zhvillohen në 3-mujorin e parë të vitit 2013.

VEPRIMTARIA HETIMORE


Gjatë kësaj periudhe SHKB-ja ka referuar pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore, **105** çështje penale për **132** punonjës policie dhe **9** shtetas, nga të cilat, **1** punonjës të nivelit të mesëm drejtues, **50** punonjës të nivelit të parë drejtues dhe **77** punonjës të nivelit zbatues dhe **4** punonjës civile, nga këta në gjendje arresti, **19** oficerë policie dhe **7** shtetas.

Nga totali i çështjeve penale të referuara, për vepra korruptive janë referuar **64** materiale kallëzuese, për **85** punonjës policie, nga të cilët, **1** punonjës i nivelit të mesëm drejtues **41** të nivelit parë drejtues dhe **39** të nivelit zbatues dhe **4** punonjës civile. Në gjendje arresti **19** oficer policie.

Tabela e kallëzimeve penale sipas veprave penale dhe niveleve të punonjësve të policisë

Viti	Lloji i veprës penale	Nr. çështjeve penale	Nr. subjekteve	Nivelet					Arrestuar/ Punonjës policie/shtetas	
				Mesëm drejtues	Parë drejtues	zbatues	punonjës civile	shtetas		
2012	Vepra korruptive	64	85	1	41	39	4	5	12	7
	Veprime arbitrare	28	31	-	5	26	-	1	-	-
	Vepra të tjera	13	16	-	4	12	-	3	7	-
	Totali	105	132	1	50	77	4	9	19	7

Paraqitja grafike e hetimeve të kryera ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë vitit 2012



Nr. i punonjësve të hetuar, sipas gradave për vitin 2012





Tabela përmbledhëse e hetimeve për vitin 2012 nga strukturat e SHKB-së

Nr.	Drejtoria/Sektorë të SHKB-së në qarqe	Nr. Kallëzimeve penale	Nr. Punonjësve të policisë	Sipas nivelit të gradave			
				Mesëm drejtues	Parë drejtues	Zbatues	Punonjës civile
1.	TIRANA	32	39	-	14	24	1
2.	SHKODRA	2	2	-	-	2	-
3.	KUKËSI	3	5	-	-	5	-
4.	LEZHA	6	7	-	2	5	-
5.	DIBRA	2	3	-	1	2	-
6.	ELBASANI	6	9	-	-	6	3
7.	DURRËSI	8	8	-	4	4	-
8.	KORCA	5	4	-	2	2	-
9.	FIERI	10	12	-	7	5	-
10.	BERATI	2	2	-	1	1	-
11.	VLORA	5	5	-	1	4	-
12.	GJIROKASTRA	12	12	-	3	9	-
13.	DREJTORIA E HETIMIT	12	24	1	15	8	-
14.	TOTALI	105	132	1	50	77	4

Paraqitja grafike e hetimeve për vitin 2012 nga strukturat e SHKB-së dhe e numrit të punonjësve të policisë të kallëzuar për ndjekje penale



Hetime të suksesshme gjatë vitit 2012

Gjatë periudhës analizuere duhet të përmendim disa hetime të suksesshme të kryera nga SHKB-ja, dhe që kanë qënë fryt i një bashkëpunimi të ngushtë ndërinstucional, duke përdorur mjetet e metodat e hetimit proaktive dhe ndjekjes së track-record (gjurmimit të rasteve). Hetimi i këtyre rasteve është realizuar në bashkëpunim dhe bashkërendim të mirë të punës midis strukturave të shërbimit në nivel qëndror e vendor, me strukturat e policisë dhe të organit të prokurorisë dhe në vecanti me njësitë hetimore të përbashkët (task forcë). Në pjesën më të madhe të hetimit të këtyre rasteve, prokurori i autorizuar, që asiston punën e shërbimit gjatë hetimit të veprimtarisë antiligjore të kryer nga punonjës policie, ka autorizuar ndjekjen e veprimeve hetimore procedurale nga strukturat e SHKB-së. Më konkretisht:

1. **Procedimi penal**, në ngarkim të 1 punonjësi policie, me gradën **Komisar**, me detyrë shef i seksionit të Hetimit dhe Parandalimit të Krimit, i hetuar për veprën penale të ÷korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksionet publike, parashikuar nga neni 259 i KP. Pas kryerjes së veprime të specializuara hetimore nga strukturat e SHKB-së dhe me vendim gjykate u bë arrestimi në flagrancë dhe caktimi i masës së sigurisë ÷Arrest me burg. Hetimet kanë përfunduar, çështja ka kaluar në gjykim dhe punonjësi i policisë është dënuar.
2. **Procedimi penal**, në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, në ngarkim të 4 punonjësve të policisë, me gradën **N/Komisar dhe Inspektor**, efektivë të strukturave të policisë kufitare në zonën e Sarandës, për implikim në kryerjen e veprave penale të ÷trafikimit të lëndëve narkotike, ÷kultivimit të lëndëve narkotike dhe ÷grupit të strukturuar kriminalë parashikuar nga nenet 283/a, 333/a, 284 e 25 të Kodit Penal. Çështja është në hetim.

3. **Procedimi penal**, në ngarkim të 1 punonjësi policie, me gradë **K/Komisar**, me detyrë shef i Komisarariatit dhe 3 shtetas, për veprat penale të òkorrupsionit pasivò, òshpërdorim detyrëo dhe òushttrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publikeo parashikuar nga nenet 259, 248 dhe 245/1 të KP. Si rezultat i përdorimit të metodave speciale të hetimit (përgjimit ambjental dhe simulimit të akteve korruptive) në datën 20.09.2012 me vendim gjykate u bë arrestimi në flagrancë i punonjësit të policisë dhe 3 shtetasve. Çështja është deleguar për hetime të mëtejshme dhe nga gjykata është vendosur masa e sigurisë òarrest shtëpieo.
4. **Procedimi penal**, në ngarkim të 1 punonjësi policie me gradë **N/Komisar**, me detyrë shef Seksionit të Anti-korrupsionit, për veprën penale të òkorrupsionit pasivò në bashkëpunim parashikuar nga neni 259 e 25 të Kodit Penal. Në datën 12.11.2012 me vendim të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është bërë ndalimi i këtij punonjësi policie dhe vazhdojnë hetimet dhe për disa punonjës të tjerë policie. Materialet paraprake ju dërguan dhe Drejtorisë së Standardeve të Policisë së Shtetit, është dhënë masa disiplinore òPërrjashtim nga Policia e Shtetitò për disa punonjës policie: **1 punonjës policie me gradën Drejtues** dhe detyrë N/Drejtor i Policisë së Qarkut, **1 punonjës policie me gradë K/Komisar** dhe me detyrë shef i sektorit të Krimit Ekonomik, **1 punonjës policie me gradë Komisar** dhe detyrë shef i seksioni të krimit ekonomik dhe **1 punonjës policie me gradën N/Komisar** dhe me detyrë specialist në seksionin e krimit ekonomik.
5. **Procedimi penal**, në ngarkim të 1 punonjësi policie me gradë **N/Komisar**, me detyrë specialist në Sektorin kundër Narkotikëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe disa shtetasve për veprat penale të òTrafikimit të lëndëve narkotikeo dhe òkorrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publikeo, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 283/a, 259 e 25 të Kodit Penal. Si rezultat i kombinimit të teknikës investigative dhe punës së kryer nga grupi hetimor, analizimit të materialit të grumbulluar u evidentua se punonjësi i policisë në bashkëpunim me shtetas të tjerë ishin të implikuar në veprimtari kriminale me shtrirje të gjerë në formën e trafikimit të lëndëve narkotike kryesisht në qytetin e Elbasanit dhe Tiranës. Në sajë të koordinimit të veprimtarisë operacionale e hetimore dhe bashkëpunimit ndërinstitutional me qasje proaktive, strukturat e SHKB-së bënë kapjen në flagrancë të punonjësit të policisë dhe bashkëpunëtorëve të tij. Gjatë këtij operacioni janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale **27.7 kg heroinë, 28 kg perzierje kokaine, 141 kg përzierje heroine, 0.8 gr kokainë; 13.100 Euro; 600.000 lekë te reja; një pistoletë e tipit TT, peshore elektronike dhe mjete të tjera për paketimin e shpërndarjen e lëndës narkotike, 26 celularë të tipeve të ndryshme, 4 automjete etj.**
6. **Procedimi penal**, në ngarkim të 1 punonjës të policisë me gradën **Komisar**, me detyrë kontrollor-specialist në Komisariatin e Policisë së Kufirit dhe Migracionit, Aeroporti Rinas, për veprën penale të òkorrupsionit pasivò dhe òshpërdorimit të detyrësò. Pas hetimit disa mujore nga strukturat hetimore të SHKB-së, u bë e mundur që të vërtetohej veprimtaria korruptive e këtij punonjësi policie i cili në këmbim të përfitimeve të paligjshme financiare, në shuma që variojnë nga 400 deri në 500 euro, ka lejuar kalimin e paligjshëm të kufirit. Në datën 10.12.2012 u krye arrestimi në flagrancë i punonjësit të policisë dhe gjykata ka dhënë masën e sigurisë òarrest në burgò.

Tabela me të dhëna për referimet e veprave penale sipas viteve

Nr. Referimeve sipas veprave penale sipas viteve	2008	2009	2010	2011	2012	Mesatarja për 5 vite
Vepra korruptive	72	56	57	63	64	62.4
Veprime arbitrare	38	35	11	21	28	26.6
Vepra te tjera	54	22	13	17	13	23.8

Grafiku sipas veprave penale dhe tendenca e tyre në vite





Tabela me të dhëna sipas viteve për numrin e punonjësve të policisë të referuar për ndjekje penale të ndarë sipas niveleve

Vitet	Nr. Punonjësve	Niveli i mesëm drejtues	Niveli i parë drejtues	Niveli zbatues
2008	202	3	76	123
2009	148	2	42	104
2010	145	1	34	110
2011	135	3	39	94
2012	132	1	50	77 /4 punonjes civile

Grafiku me të dhëna sipas viteve për numrin e punonjësve të policisë të referuar për ndjekje penale të ndarë sipas niveleve (gradave) të punonjësve të Policisë së Shtetit



TRAJTIMI I ANKESAVE TË SHKETASVE PËR PUNONJËS TË POLICISË SË SHKETIT

Edhe gjatë vitit **2012**, strukturat e SHKB-së në nivel qendror dhe vendor kanë marrë dhe kryer verifikime për ankesat e ardhura, objekt i të cilave ka qenë implikimi i mundshëm i punonjësve të Policisë së Shtetit, në veprimtari të kundraligjshme si: shpërdorim detyre, veprime arbitrare, qëndrime të njëashme në zgjidhjen e konflikteve të pronësisë, gjoha të padrejta nga punonjës të policisë rrugore, tejkalim të kompenave ligjore etj. Për periudhën analizuese janë marrë dhe verifikuar **625** ankesa prej të cilave, janë **268** letër - ankesa dhe **357** telefonata (ankesa).

Pas shqyrtimit dhe verifikimit për **268** letër-ankesat rezultat e përfuara jepen sipas tabelës së mëposhtme:

Të dhëna për veprimtarinë administrative (letëranksa) për vitin 2012


Ardhur nga Institucioni /shtetas	Nr. Letër-ankesave	Në proces verifikimi	Ankesa nuk qëndron	Ankuesi ka hequr dorë nga ankesa	Eshte kerkuar fillimi i ecurisë disiplinore	Ka shërbyer si indicje per fillimin e nje hetimi penal	Duhet te shprehet Prokuroria apo Gjykata	Nuk është objekt i punës së SHKB
Kryeministri	1	-	1	-	-	-	-	-
Ministri	55	-	37	-	8	-	6	4
SHKB-se	59	-	40	-	8	3	5	3
DMPP	43	-	32	-	3	2	3	3
DPPSH	28	-	17	-	4	2	4	1
Zyra e Ankesave	49	1	38	1	3	4	2	-
Sektoret e SHKB-se	25	-	19	1	4	-	1	-
Institucione tjera	8	-	4	-	-	1	-	3
TOTALI	268	1	188	2	30	12	20	14



Ndërsa në numrin telefonik (pa pagesë) **0800 90 90**, janë kryer **357** telefona (ankesa) që pas shqyrtimit dhe verifikimit të tyre, rezultojnë të dhënat e paraqitura në tabelë:

Muaji	Numri i telefonatave nga shtetas	Ankesa nuk qëndron	Ankuesi nuk është paraqitur	Problemi është zgjidhur	Ne proces verifikimi	Ankuesi ka hequr dorë nga ankesa	Kërkuar fillimi i ecurisë disiplinore	Nuk është objekt i SHKB-së	Pritet vendimi i Prokurorisë
Janar	34	13	6	7	5	-	-	3	-
Shkurt	34	13	6	4	4	2	1	4	-
Mars	46	11	13	7	5	1	-	9	-
Prill	44	11	4	7	13	-	-	9	-
Maj	20	4	5	4	5	-	-	2	-
Qershor	36	10	3	2	8	-	-	13	-
Korrik	31	7	7	4	3	-	2	8	-
Gusht	32	6	8	3	4	-	2	9	-
Shtator	21	3	4	2	5	-	3	4	-
Tetor	25	2	12	2	1	-	3	4	1
Nentor	19	3	10	3	2	-	-	1	-
Dhjetor	15	5	5	2	1	-	1	-	-
TOTALI	357	88	83	47	57	3	12	66	1

Grafiku i telefonatave (ankesave) në linjën jeshile 0800 90 90



BASHKËPUNIMI ME DREJTORINË E STANDARDEVE PROFESIONALE NË POLICINË E SHTETIT

Edhe për vitin 2012, bashkëpunimi midis Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm dhe Drejtorisë së Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit, ka vazhduar me intesitet të plotë dhe me qëllim primar evidentimin dhe ndëshkimin e rasteve të sjelljeve të këqija nga punonjës policie gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj.

Për vitin 2012, gjatë veprimtarisë hetimore të strukturave të SHKB-së janë konstatuar **80** raste ku punonjësit e policisë nuk kanë konsumuar elementë të veprës penale, por kanë kryer shkelje disiplinore.


Mbi bazën e dokumentacionit të dërguar nga ana jonë nga Drejtoria e Standardeve Profesionale është inicuar ecuria disiplinore për **70** punonjës policie.

Ndërsa Drejtoria e Standardeve Profesionale ka bërë kërkesë për **13** raste, ku nga ana jonë është dërguar një informacion i plotë mbi rezultatet e hetimeve penale të kryera ndaj punonjësve të policisë.

Nga **93** praktika disiplinore, të evidentuara më lartë, nga Drejtoria e Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit, janë dhënë këto rezultate për ecurinë disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë kryer shkelje të ligjit dhe rregullave që normojnë punën e policisë:


- Në **10** raste ka rezultuar “shkelje e lehtë disiplinore”
- Në **2** raste është dhënë “vërejtje”
- Në **2** raste është dhënë “vërejtje me paralajmërim”
- Në **2** raste është dhënë “gjobë në masën 5 ditë”
- Në **1** rast është dhënë “pezullim pa pagesë 5 ditë”
- Në **3** raste është dhënë “pezullim pa pagesë 10 ditë”
- Në **3** raste është dhënë “pezullim pa pagesë 15 ditë”
- Në **1** rast është dhënë “pezullim pa pagesë 20 ditë”
- Në **2** raste është dhënë “pezullim pa pagesë 30 ditë”
- Në **4** raste është dhënë “shtyrje e afatit të gradimit 3 muaj”
- Në **5** raste është dhënë “shtyrje e afatit të gradimit 6 muaj”
- Në **4** raste është dhënë “shtyrje e afatit të gradimit 12 muaj”
- Në **2** raste është dhënë “ulje në gradë për 6 muaj”
- Në **3** raste është dhënë “largim nga puna”
- Në **23** raste është dhënë “përfundim nga Policia e Shtetit”
- Në **26** raste është përcaktuar përfundimi i ecurisë disiplinore (nuk ka patur shkelje të rëndë disiplinore)

Paraqitja grafike e masave disiplinore të aplikuara nga bashkëpunimi me SHKB-në



VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË INSPEKTIMEVE

Drejtoria e Inspektimit pranë SHKB-së, për vitin 2012, sipas planit vjetor të inspektimit, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm ka zhvilluar 17 inspektime në Drejtoritë e Policisë së Qarqeve (DPQ), në Drejtoritë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin (DRKM), në Njësitë Rajonale të Policisë Rrugore (NJRPRR), në Njësinë e Kontrollit të Autostradave, në Komisaratin Special ëReneaö, si dhe ka zhvilluar 2 inspektime të jashtëzakonshme në bashkëpunim me Departamentin e Hetimit.



Inspektime të kryera në Drejtoritë e Policisë së Qarqeve (DPQ)

1. Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë - periudha e inspektimit 10.01.2012 - 28.02.2012, Objekti: ÷Vlerësimi i kryerjes së detyrave të DPQ, Tiranë.
2. Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër - periudha e inspektimit 16.05.2012 - 15.06.2012, Objekti: ÷Vlerësimi i kryerjes së detyrave të DPQ, Dibër
3. Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës - periudha e inspektimit 16.06.2012 - 31.07.2012, Objekti ÷Vlerësimi i kryerjes së detyrave të DPQ, Durrës
4. Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë - periudha e inspektimit 01.09.2012 - 30.09.2012 Objekti ÷Vlerësimi i kryerjes së detyrave të DPQ, Gjirokastrë

Ndër konstatimet kryesore përmendim:

1. Konstatohet vendosja e objektivave formal dhe të paarritshëm në strategjitë një-vjecare, pa u bazuar në metodën e krahasimit të treguesve të punës me vitin paraardhës.
2. Mungesa e një akti ku të përcaktohet dokumentacioni që duhet të administrojë një punonjës i strukturës së hetimit të krimit sipas funksioneve organike.
3. Moszbatimi i të gjitha kërkesave të udhëzimit nr. 474, datë 27.09.2007 ëPër përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave.
4. Mungon një strategji lidhur me hetimin e ngjarjeve të vjetra
5. Qarkullimi, transferimi i specialistëve të Hetimit të Krimit pa ndonjë studim paraprak, në periudha të shkurtra kohë, duke mos u bazuar në kriteret e meritokracisë, procesi i vlerësimit të punës fiktiv. Lëvizjet e shpeshta shoqërohen me mosdorëzimin në kohë të dokumentacionit që administrohet prej tyre.

6. Në ripranimet e bëra nuk u jepet përparësi punonjësve të policisë që gjenden me pagesë kalimtare brenda një viti nga çasti që kanë fituar pagesën kalimtare në raport me kandidaturat e tjera sipas gradës, në kundërshtim me Nenin 90 të Ligjit Nr. 9749, të PSH.
7. Në Sektorin e Burimeve Njerzore mungon lista e funksioneve, në të cilën përfshihen periudhat minimale të qëndrimit në ato funksione.
8. Mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm sipas hierarkisë epror-vartës.
9. Mangësi në njohjen e akteve që normojnë punën dhe veprimtarinë e punonjësve të policisë.
10. Mosimplementim sa duhet i njohurive të marra në trajnimet e shpeshta të zhvilluara nga ana e punonjësve të policisë.
11. Mosnjohuri të mjaftueshme dhe moszbatim i Procedurave Standarde të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike.
12. Raste të mospërputhjes gradë-funksion, si në pozicionet drejtuese ashtu dhe në ato të nivelit zbatues.
13. Mungesa të koordinimit të punës me pushtetin lokal në lidhje me problematikën e dhunës në familje.
14. Kushtet në dhomat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave, në përgjithësi nuk janë në përputhje me Procedurat Standarde të Punës. (shih. Raportin Vjetor 2010 & 2011)
15. Mungesa në pajisje me veshje dhe mjete të nevojshme për punë, sidomos problematike në strukturat vendore periferike.
16. Punonjësit e Policisë së Shtetit janë të papajisur me veshje dhe mjete të nevojshme për punë. Në strukturat vendore periferike kjo mungesë është shqetësuese.

Ndër rekomandimet kryesore përmendim:

1. Hartimi i Strategjisë Vjetore të DPQ-së të bëhet në bazë të studimeve dhe përcaktimit të objektivave konkretë dhe të matshëm.
2. Të përcaktohet me akt normativ dokumentacioni, i cili duhet të administrohet nga strukturat e hetimit të krimit në DPQ.
3. Të zbatohen me përpikmëri kërkesat e udhëzimit Nr.1474, datë 27.09.2007 për përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave.
4. Të hartohet një strategji lidhur me hetimin e ngjarjeve të vjetra. (shih. Raportin Vjetor 2011)
5. Qarkullimi i specialistëve të Hetimit të Krimit të bëhet mbi bazën e një studimi paraprak mbështetur në kriteret e meritokracisë dhe nevojat e strukturave.
6. Sistemi i kontrollit të brendshëm, të funksionojë në mënyrë të tillë që të sigurojë kontroll të vashdushtë dhe eficient të strukturave të PSH.
7. Punonjësit e policisë të njihen në vazhdimësi me aktet që normojnë punën dhe veprimtarinë e tyre.
8. Të sigurohet baza materiale e nevojshme për dokumentimin e veprimtarisë së strukturave dhe punonjësve të policisë.
9. Të përputhet grada me funksionin si në pozicione të nivelit drejtues ashtu edhe në nivele zbatuese.
10. Të njihen dhe të zbatohen me rigorozitet Procedurat Standarde të Punës për Rendin dhe Sigurinë Publike, në mënyrë të veçantë në nivel komisarati.
11. Të përmirësohet bashkëpunimi me organet e pushtetit lokal dhe OJF për trajtimin e viktimave të dhunës në familje, kryesisht në nivel komisarati.
12. Të përmirësohen kushtet në dhomat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të personave në përputhje me Procedurat Standarde të Punës dhe trajtimi i tyre të jetë konform standardeve. (shih. Raportin Vjetor 2010 & 2011)
13. Për çdo transferim që kryhet të zbatohet me rigorozitet ligji Nr. 9749, datë 04.06.2007 i Policisë së Shtetit, Manuali i Procedurave Standarde të Punës në Policinë e Shtetit dhe Rregullorja e Personelit.

14. Për ripranimet, t'ua jepet përparësi punonjësve të policisë që trajtohen me pagesë kalimtare, sic parashikohet në Nenin 90 të Ligjit për Policinë e Shtetit.
15. Të përpilohet lista e funksioneve, në të cilën përfshihen periudhat minimale të qëndrimit në ato funksione siç parashikohet në pika 3, Neni 39, e Rregullores së Personelit.

Inspektime të kryera në Drejtorite Rajonale për Kufirin dhe Migracionin (DRKM)

1. Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Tiranë - periudha e inspektimit 01.03.2012 ó 15.04.2012, Objekti: ÷Vlerësimi i kryerjes së detyrave të DRKM, Tiranë.
2. Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Shkodër - periudha e inspektimit 16.04.2012 ó 15.05.2012, Objekti: ÷Vlerësimi i kryerjes së detyrave të DRKM, Shkodër.
3. Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Dibër - periudha e inspektimit 16.05.2012 ó 15.06.2012, Objekti: ÷Vlerësimi i kryerjes së detyrave të DRKM Dibër.
4. Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Durrës - periudha e inspektimit 16.06.2012-31.07.2012, Objekti: ÷Vlerësimi i kryerjes së detyrave të DRKM Dibër.
5. Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Gjirokastrë - periudha e inspektimit 01.09.2012 ó 30.09.2012 Objekti: ÷Vlerësimi i kryerjes së detyrave të DRKM Gjirokastrë.

Ndër konstatimet kryesore përmendim:

1. Strategjitë njëvjeçare të DRKM-ve nuk kanë gjetur implementim të plotë. (shih. Raportin Vjetor 2010 & 2011)
2. Nuk zbatohet me korrektësi ligji procedural penal dhe ligji për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit, në rastet e kalimit të paligjshëm të kufirit dhe të tentativës për kalim të paligjshëm.
3. Ka mungesë bashkëpunimi me strukturat homologe kufitare, për sa i përket krimit ndërkufitar, lehtësimit të procedurave të hyrje daljeve, si dhe trajtimit të personave deportiv dhe INAD.
4. Ka mungesë të burimeve njerëzore për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit.
5. Në shumicën e pikave të kalimit kufitar, shërbimet e policisë kufitare operojnë në të njëjtën kabinë kontrolli me shërbimet doganore, praktikë e cila krijon mundësi për rrjedhjen e informacionit të klasifikuar.
6. Hapat procedural për trajtimin e personave Deportiv dhe INAD, janë të shpërndara në akte të ndryshme. Mospërfshirja e tyre në një procedurë të vetme, krijon mangësi në ecurinë e punës.
7. Nuk ekziton një procedurë administrative, në lidhje me praktikën e personave Deportiv.
8. Nuk referohen në Prokurori personat e kthyer, të cilët deklarorin që kishin kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme, kur vepra penale nuk i kishte kaluar afatet e parashkrimit.
9. Nuk zbatoheshin me korrektësi masat ndëshkimore administrative për raste të tilla.
10. Ka mungesë mjetesh logjistike për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit të gjelbër, kryesisht gjatë natës.
11. Kontrolli i të huajve të parregullt në territorin e DRKM-ve, nuk rezulton efikas.
12. Procedura e miratimit të lejeve të qëndrimit rezulton shumë burokratike, pasi vendimmarrja bëhet nga Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, pas propozimit të Drejtorisë Rajonale dhe në shumicën e rasteve tejkalohet afati 30 ditor që përcakton ligji.
13. Punonjësit e policisë janë të papajisur me veshje dhe mjete të nevojshme për punë. Në strukturat vendore periferike kjo mungesë është shqetësuese.
14. Në ripranimet e bëra nuk u jepet përparësi punonjësve të policisë që gjenden me pagesë kalimtare brenda një viti nga çasti që kanë fituar pagesën kalimtare në raport me kandidaturat e tjera sipas gradës, në kundërshtim me Nenin 90 të Ligjit Nr. 9749, të PSH.
15. Në Sektorin e Burimeve Njerëzore mungon lista e funksioneve, në të cilën përfshihen periudhat minimale të qëndrimit në ato funksione.

Ndër rekomandimet kryesore përmendim:

1. Të zbatohet me përpikmëri strategjia nga DRKM-të përkatëse. (shih. Raportin Vjetor 2010 & 2011)
2. Të zbatohet me korrektësi ligji procedural penal dhe ligji për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit, në rastet e kalimit të paligjshëm të kufirit dhe të tentativës për kalim të paligjshëm.
3. Të përmirësohet bashkëpunimi me strukturat homologe kufitare, sa i përket krimit ndërkuftar, lehtësimit të procedurave të hyrje daljeve, si dhe trajtimit të personave deportiv dhe INAD.
4. Të rritet numri i punonjësve për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit.
5. Shërbimet e policisë kufitare të operojnë në kabina kontrolli të veçanta nga shërbimet doganore.
6. Të unifikohen aktet që përcaktojnë hapat procedural për trajtimin e personave Deportiv dhe INAD.
7. Të hartohet procedurë standarte, në lidhje me administrimin e praktikave për personat Deportiv dhe INAD.
8. Të nxirret një akt, për dokumentimin e të dhënave të marra në rastin e intervistimit të personave të kategorive Deportiv.
9. Të referohen në Prokurori rastet e personave të kthyer, të cilët deklarojnë se kanë kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme, kur vepra penale nuk i ka kaluar afatet e parashkrimit, si edhe të zbatohen me korrektësi masat ndëshkimore administrative për raste të tilla.
10. Të bëhet pajisja e strukturave të DRKM-ve me mjete logjistike për kontrollin dhe mbikqyrjen e kufirit, kryesisht gjatë natës.
11. Të përmirësohet puna si edhe të forcohet bashkëpunimi me struktura të tjera të PSH-së për kontrollin e të huajve të parregullt në territorin e DRKM-ve.
12. Të lehtësohen procedurat e miratimit të lejeve të qëndrimit për të huajt.
13. Të sigurohen veshjet dhe mjetet e nevojshme për punë (kamera termike, live scanner, pajisje të vijës së dytë të kontrollit). Në strukturat vendore periferike kjo mungesë është shqetësuese.
14. Për ripranimet, t'u jepet përparësi punonjësve të policisë që trajtohen me pagesë kalimtare, siç parashikohet në Nenin 90 të Ligjit për Policinë e Shtetit.
15. Të përpilohet lista e funksioneve, në të cilën përfshihen periudhat minimale të qëndrimit në ato funksione siç parashikohet në pika 3, Neni 39, e Rregullores së Personelit.

Inspektime të kryera në Njësitë Rajonale të Policisë Rrugore (NJRPRR)

1. Njësia Rajonale e Policisë Rrugore Tiranë - periudha e inspektimit 01.03.2012- 15.04.2012, ÷Vlerësimi i kryerjes së detyrave të NJRPRR, Tiranë ÷.
2. Njësia Rajonale e Policisë Rrugore Shkodër - periudha e inspektimit 16.04.2012 ó 15.05.2012 ÷Vlerësimi i kryerjes së detyrave të NJRPRR, Shkodër ÷.
3. Njësia Rajonale e Policisë Rrugore Dibër - periudha e inspektimit 16.05.2012 ó 15.06.2012 ÷Vlerësimi i kryerjes së detyrave të NJRPRR, Dibër ÷.
4. Njësia Rajonale e Policisë Rrugore Gjirokastrë - periudha e inspektimit 01.09.2012 ó 30.09.2012 ÷Vlerësimi i kryerjes së detyrave të NJRPRR, Gjirokaster ÷.
5. Njësia Rajonale e Policisë Rrugore Berat - periudha e inspektimit 02.10.2012 ó 31.10.2012 ÷Vlerësimi i kryerjes së detyrave të NJRPRR, Berat ÷.
6. Njësia Rajonale e Policisë Rrugore Fier - periudha e inspektimit 02.10.2012 ó 31.10.2012 ÷Vlerësimi i kryerjes së detyrave të NJRPRR, Fier ÷.

Ndër konstatimet kryesore përmendim:

1. NJRPRR-të nuk kanë miratuar strategji një-vjeçare në nivel rajonal me objektiva të qartë, të matshem dhe të arritshëm. (shih. Raportin Vjetor 2011)
2. Struktura e Policisë Rrugore duke qenë e centralizuar krijon mungesë fleksibiliteti në menaxhimin e Njësive Rajonale.

3. Mbajtja dhe administrimi i dokumentacionit nuk bëhej sipas Urdhrit Nr.1284 datë 14.10.2010 òPër dokumentacionin që duhet të mbahet dhe administrohet nga personeli i policisë rrugore.
4. Nuk zbatohen me përpikmëri kërkesat e Kodit Rrugor në RSH dhe kërkesat e Udhëzimit Nr. 388, datë 02.11.2010, i Ministrisë të Brendshme òPër mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe administrimin e gjobave në fushën e qarkullimit rrugor. (shih. Raportin Vjetor 2011).
5. Mbulimi me shërbim për kontrollin e akteve kryesore gjatë natës ishte minimal
6. Vjelja e gjobave ishte në nivele të ulëta.
7. Mungon totalisht bashkëpunimi me komunitetin, median dhe autoritetet vendore në lidhje me sensibilizimin e qytetarëve për zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor.
8. Sektori i shërbimeve mbështetëse ka mbingarkesë pune, pasi ky sektor kryen edhe sekretarinë.
9. Nuk ka bashkëpunim të mirë me filialet e bankave të kontraktuara për arkëtimet e gjobave dhe mos hedhja në kohë në sistem nga ana e specialistëve të financës (operator në rrethe), bënte që drejtuesit e mjeteve të rezultonin debitor dhe pse i kishin shlyer detyrimet.
10. Konstatohet se mandat arkëtimet e derdhjeve të gjobave në filialet e bankave dhe Posta Shqiptare nuk dorëzoheshin brenda ditës në NJRPRR. Kjo krijonte probleme me qytetarët sepse ata rezultonin debitor në sistem edhe pasi e kishin paguar masën administrative në filialet e bankave ose në Postën Shqiptare.
11. Vihet re një tendencë e punonjësve të policisë rrugore për të vënë gjopa thjesht për efekte statistikore duke patur parasysh edhe numrin e masave administrative të vëna për kundravajtje e lehta. (shih. Raportin Vjetor 2011)
12. Puna e operatorit për hedhjen e gjobave, ka dinamikë të ngjeshur ku njëkohësisht komunikonte me qytetarët, me punonjësit e shërbimit që kërkojnë verifikimin e targave dhe hedhjen e masave administrative në sistem.
13. Në lidhje me hedhjen e òproces-verbaleve të konstatimit të shkeljesë rezultoi se puna e operatores nuk monitorohet, nuk ka rakordim për verifikimin e regjistrimit të gjobave, sasinë e gjobave të hedhura në sistem, sasinë e tyre të arkëtuar me blloqet e shpërndara. (shih. Raportin Vjetor 2011)
14. Punonjësit janë të papajisur me veshje dhe mjete të nevojshme për punë (radio, radar, teste alkooli). Në strukturat vendore periferike kjo mungesë është shqetësuese.
15. Punonjësit e policisë aktivizohen në punë mbi 40 orë në javë, mbi 22 ditë në muaj (paguhen vetëm për 22 ditë), aktivizimi tyre në kundërshtim me neni 69 të Rregullores së Brendshme për PSH si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore.
16. Vjelja e masave administrative është në nivele të ulëta me një tendencë për të rritur numrin statistikor se në kontrollin e dokumentacionit dhe parandalimin e aksidenteve.

Ndër rekomandimet kryesore përmendim:

1. Hartimi dhe miratimi i strategjive një vjeçare në nivel rajonal për çdo NJRPRR me objektiva të matshem dhe të arritshëm. (shih. Raportin Vjetor 2011)
2. Mbajtja dhe administrimi i dokumentacionit të bëhet sipas Urdhrit Nr.1284, datë 14.10.2010 òPër dokumentacionin që duhet të mbahet dhe administrohet nga personeli i policisë rrugore.
3. Të zbatohen me përpikmëri kërkesat e Kodit Rrugor në RSH dhe Udhëzimit Nr. 388, datë 02.11.2010, të Ministrisë të Brendshme òPër mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe administrimin e gjobave në fushën e qarkullimit rrugor.
4. Të përmirësohet mbulimi me shërbim i akteve kryesore gjatë natës.
5. Të rritet bashkëpunimi me komunitetin, median dhe autoritetet vendore në lidhje me sensibilizimin e qytetarëve për zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor. (shih. Raportin Vjetor 2011)

6. Të bëhen studime të hollësishme në lidhje me marrjen e masave parandaluese për minimizimin e numrit të aksidenteve rrugore.
7. Të përmirësohet puna dhe të organizohen shërbime periodike në interes të vjeljes së plotë të gjobave.
8. Të shtohet organika e Sektorit të shërbimeve mbështetëse me punonjësin e sekretarisë.
9. Të rritet bashkëpunimi me filialet e bankave dhe Postës Shqiptare të kontraktuara për arkëtimet e gjobave dhe të bëhet hedhja e tyre në kohë në sistem nga ana e specialistëve të financës (operator në rrethe).
10. Të bashkëpunohet me filialet e bankave dhe Postës Shqiptare për dorëzimin e mandat arkëtimeve e derdhjeve të gjobave brenda ditës në NJRPRR.
11. Masat e gjobave të vëna nga punonjësit e policisë rrugore të korrespondojnë me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara. (shih. Raportin Vjetor 2011)
12. Të sigurohet veprimtari normale e punës së operatorit, duke patur parasysh dinamikën e ngjeshur.
13. DPRR, NJRPRR të respektojnë nenin 69 të Rregullores së Brendshme për PSH si dhe aktet e tjera ligjore për kohëzgjatjen e punës/shërbimit dhe pushimit për punonjësit e policisë.
14. DPRR në bashkëpunim me NJRPRR të hartojnë një planë masash për verifikimin e mjeteve debitor me qëllim rritjen e vjeljes së gjobave.

Inspektimi i Njesisë së Kontrollit të Autostradave me objekt; “Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Njesisë së kontrollit të autostradave dhe trafikut interurban” – periudha e inspektimi 01.11.2012 – 30.11.2012

Ndër konstatimet kryesore përmendim:

1. Mungesa e një plan veprimi me objektiva dhe prioritete të matshëm dhe arritshëm, në mënyrë që të matej performanca e kësaj strukture policore.
2. Ndryshimi dhe krijimi i NJKA-së, nuk është bërë mbi baza argumentuese dhe shpjeguese duke patur parasysh kritere që kanë të bëjnë me arsyet që e bëjnë të domosdoshëm ndryshimin, nevojat njerëzore, financiare e materiale dhe mënyrën e realizimit të tyre, risia që sjell ndryshimi i propozuar, si dhe rritja e efektivitetit dhe efikasitetit të një shërbimi policor.
3. Seksioni i sigurisë dhe linjave në Tirane, i cili i është bashkangjitur NJKA-së në muajin mars 2011, mbetet gjithashtu një ndryshim strukturor i paargumentuar, duke patur parasysh detyrat dhe përgjegjësitë funksionale të kësaj njësie.
4. Në manualin e funksionimit të Njesisë pavarësisht parashikimit dhe përcaktimit të detyrave lidhur me planifikimin, analizën dhe statistikën, nuk ekzistonin funksione të tilla organike me përshkrime pune të qarta. Për kryerjen e detyrave të planifikimit, analizës dhe statistikës ishin komanduar punonjës nga seksioni teknik dhe ai i kontrollit të autostradave.
5. Detyrat dhe përgjegjësitë funksionale të Seksionit Teknik dhe Seksionit të Kontrollit të autostradave rezultuan të dubluara, duke mos kuptuar qartë ku fillon dhe ku mbaron përgjegjësia e një seksioni gjatë kryerjes së shërbimeve. Gjatë gjithë periudhës, që nga momenti i krijimit të strukturës, kanë funksionuar dhe janë investuar duke kryer detyra të njëjta.
6. NJKA-ja nuk ka mbajtur statistika dhe analiza në mënyrë periodike në mënyrë që të matej dhe dokumentohej dinamika e kësaj strukture. Nuk ishin mbajtur analiza, 3 mujore, 6 mujore dhe 9 mujore.
7. U konstatua që në zbatim të pikës 4 të manualit të funksionimit të njesisë pas angazhimit me shërbim sipas rastit të dy seksioneve, duhej të krijoheshin dhe dokumentohej një praktike me 6 dokumente. Rezultoi që këto praktika ishin të shpërndara në mënyrë të çrregullt dhe nuk ishin dokumentuar.

8. Mbajtja dhe administrimi i dokumentacionit në zbatim të Urdhrit Nr.1284, datë 14.10.2010
Për dokumentacionin që duhet të mbahet dhe administrohet nga personeli i policisë rrugore në përgjithësi rezultoi në përputhje me këtë urdher.
9. U konstatua mungesa e bashkëpunimit e NJKA-së me DPQ Tiranë lidhur me shkëmbimin e informacioneve mbi të dhënat e personave në kërkim dhe automjeteve në kërkim.

Ndër rekomandimet kryesore permendim:

1. Ndryshimet strukturore të bëhen mbi baza argumentuese dhe shpjeguese duke pasur parasysh kriteret me arsyet që e bëjnë të domosdoshëm ndryshimin, nevojat njerëzore, financiare e materiale dhe mënyrën e realizimit të tyre, risia që sjell ndryshimi i propozuar, si dhe rritja e efektivitetit dhe efikasitetit të një shërbimi policor.
2. Të parashikohen trajnimet e nevojshme për punonjësit e policisë rrugore lidhur me njohjen e akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë punën e Policisë së Shtetit, pasi ka rezultuar një handikap i madh në këtë drejtim.

Inspektimi i Komisarariatit Special “RENEA” me objekt; “Vlerësimi i kryerjes së detyrave të Komisarariatit Special Renea” – periudha e inspektimit 01.11. 2012 – 30.11.2012

Ndër konstatimet kryesore përmendim:

1. Në Komisariatin Special òRENEAö, u konstatua se nuk ka një akt n/ligjor të DPPSH, i cili të përcaktojë: Rregulloren e Brendshme, përkrahjet e punës dhe detyrat funksionale për të gjithë funksionet, në përputhje me ndryshimet organike dhe llojin dhe mënyrën e administrimit të dokumentacionit dhe për të gjithë punonjësit.
2. Për periudhën objekt inspektimi nga kjo strukturë janë kryer 118 shërbime. Nga verifikimi i praktikave rezultoi se Komisariatit Special òRENEAö nuk i është dërguar kopje e planit të masave të hartuar prej strukturave lokale të DPPSH-së.
3. Në Komisariatin Special òRENEAö, u konstatua mungesa e sistemit TIMS, adresave të komunikimit të brendshëm, çertifikatave të sigurisë për punonjësit e të gjitha niveleve.
4. Në Seksionin e Shërbimit Shëndetësor nga verifikimi i kartelave mjekësore të efektivitetit rezultoi se nuk janë pasqyruar vizitat mjekësore vjetore të detyrueshme, kryesisht për punonjësit e nivelit drejtues.
5. Në varësi ekonomike të Komisarariatit Special òRENEAö janë dhe tre njësi (Njësia e negociatorëve, Njësia Speciale e antiëksplzivave dhe Komisarati Special i Helikopterave) por nuk ka akt normativ apo rregullore që të normoj funksionimin e këtyre njësive në varësi të Komisarariatit.
6. Strukturat e DPPSH, Strukturat Ekonomike, Departamenti për Sigurinë Publike nuk kanë bërë òSigurim Jeteö për punonjësit e Komisarariatit Special òRENEAö, për vetë natyrën e veçantë të punës që kryejnë dhe riskun e lartë që mbartin.
7. Ambienti dhe kushtet e punës së Komisarariatit Special òRENEAö nuk plotësonin nevojat, qëllimet dhe objektivat e Komisarariatit.

Ndër rekomandimet kryesore permendim:

1. Komisarati Special òRENEAö në bashkëpunim me DPPSH (Departamentin e Rendit dhe Sigurisë Publike) të hartojë dhe miratojë Rregulloren e Brendshme, përkrahjet e punës dhe detyrat funksionale për të gjithë funksionet, në përputhje me ndryshimet organike dhe llojin, mënyrën e administrimit të dokumentacionit për të gjithë punonjësit.
2. Të respektohen Procedurat Standarde të Punës dhe Rregullorja e FLO-së në lidhje me dokumentacionin që duhet të administrohet për shërbimet e kryera nga Komisarati Special òRENEAö me strukturat lokale të DPPSH-së.

3. Nga DPPSH të merren masa për paisjen me sistemin TIMS, adresa të komunikimit të brendshëm, certifikatat e sigurisë për punonjësit e të gjitha niveleve.
4. Shefi i Seksionit të Shërbimit Shëndetësor të bëjë pasqyrimin e plotë të vizitave mjekësore vjetore të detyrueshme për të gjithë punonjësit.
5. Komisarati Special òRENEAö ti drejtohet DPPSH (F.L.O, Departamentit për Shërbimet Mbështetëse, Strukturave Ekonomike) për normimin dhe funksionim e Njesisë së Negociatorëve, Njesisë Speciale të Antiexplozivave dhe Komisaratin Special të Helikopterave që trajtohen financiarisht.
6. DPPSH, Strukturat Ekonomike, të marrin masa për sigurimin e jetës për të gjithë punonjësit e policisë, vecanërisht për kategorinë e punonjësve që kanë risk më të lart në punë. Të marrin masa për tre njësitë me Komisaratin Special òRENEAö, në lidhje me disiplinimin dhe normimin e varësis ekonomike.

Inspektime të jashtëzakonshme në bashkëpunim me Departamentin e Hetimit

Drejtorja e Inspektimit ka zhvilluar inspektimin me objekt: Vlerësimi i kryerjes së detyrave lidhur me veprimtarinë kriminale të shtetasit Viktor Gushi ö ö periudha e inspektimit 24.09. 2012 ö 08.10.2012

Drejtorja e Inspektimit ka zhvilluar inspektimin me objekt: òInspektimi i veprimtarisë së strukturave të Policisë së Shtetit në kryerjen e veprimeve hetimore proçeduriale, lidhur me veprimet e dhunshme të organizuara në demonstratën e datës 21.01.2011ö ö periudha e inspektimit 01.02.2012 ö 11.02.2012.

REKOMANDIME PËR POLICINË E SHETIT

- Hartimin e strategjive apo planeve një-vjecare të punës për cdo strukturë të Policisë së Shtetit, me objektiva dhe detyra të matshme dhe të përcaktuara në bazë të mënyrës krahasuese më të dhënat e vitit paraardhës.
- Ndjekja e praktikave më të mira në lidhje me procedurat e rekrutimit, përzgjedhjes, emerimit, transferimit dhe ngritjes në detyrë të punonjësve të Policisë së Shtetit në nivel qendror e vendor.
- Trajnimi i vazhdueshëm por dhe implementimi në praktik i njohurive të marra, sidomos në drejtim të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit brenda oraganizatës së policisë.
- Rishikimet dhe ndryshimet strukturore në Policinë e Shtetit, të paraprihen nga studime profesionale e transparente, me qëllim evidentimin e problemeve, nivelin dhe shkallën e nevojshmërisë për kryerjen e këtyre ndryshimeve.
- Zbatimin me rigorozitet të Procedurave Standarde të Punës dhe akteve të tjera nënligjore që normojnë punën dhe veprimtarinë e çdo punonjësi dhe strukture policie në nivel vendor e qendror.
- Rritja dhe forcimi i mekanizmave të vetë-kontrollit dhe llogaridhënies sipas shkallës së hierarkisë, nga strukturat qendrore në strukturat vartëse, nëpërmjet inspektimeve, auditimeve dhe hetimeve të shkeljeve disiplinore.
- Kryerja e inspektimeve të përbashkëta me SHKB-në, për mbikqyrjen e zbatimit të politikave dhe direktivave (urdhrave të shërbimit) etj, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, që lidhen me integritetin e punonjësve të policisë.

OBJEKTIVA PËR SHKB-në gjatë vitit 2013

Tashmë nevojitet progres i mëtejshëm në:

1. Konsolidimin e strukturave hetimore dhe të inspektimit të SHKB-së, në nivel qendror dhe vendor duke synuar rritjen e performancës në kryerjen e detyrës.
2. Realizimin e objektivave të veprimtarisë së SHKB-së, të fokusuar në tre shtylla kryesore:
 - **veprimtarinë hetimore** ÷ Parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe hetimin paraprak të veprave penale, të kryera nga punonjësit e Policisë së Shtetit, pavarësisht funksionit dhe gradës, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të sajë dhe
 - **veprimtarinë inspektuese** ÷ Inspektimi i punës në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit për përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara, për garantimin e përgjegjshmërisë, efektshmërisë dhe efikasitetit të tyre.
 - **veprimtarinë parandaluese** ÷ kryerja e testit të integritetit për punonjësit e policisë, si një teknikë që do të verifikojë figurën dhe etikën e punonjësve dhe do të masë tundimin e tyre ndaj korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të ligjit dhe etikës.
3. Menaxhimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të personelit të SHKB-së (burimeve njerëzore), në bashkëpunim të ngushtë dhe me partnerët si ICITAP, OSCE, TIKA, PAMECA etj.
4. Rritjen e efektivitetit të hetimit të korrupsionit sidomos ndaj zyrtarëve të lartë të Policisë së Shtetit, duke aplikuar teknika të posaçme hetimore, si dhe gjurmimin e konfiskimin e aseteve kriminale që rrjedhin nga korrupsioni.
5. Fokusimi i vazhdueshëm dhe i mëtejshëm në veprimtarinë proaktive dhe krijimin e protokolleve operacionale efikasë në goditjen e veprimtarisë kriminale, sidomos të krimit të organizuar.
6. Rritja e kapaciteteve hetimore kundër korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të ligjit, duke përmirësuar aplikimin e teknikave të posaçme, gjurmimin dhe sekuestrimin e aseteve kriminale, rritja e bashkëpunimit me institucionet e tjera ligj-zbatuese si, Prokurorinë, Policinë e Shtetit, Shërbimet Informative, etj.
7. Rritja e bashkëpunimit me qytetarët në denoncimin e korrupsionit, qoftë dhe nëpërmjet shpërblimit financiar të tyre.
8. Bashkëpunimi me Prokurorinë e Gjykatën në krijimin e një statistike të qëndrueshme mbi ecurinë e hetimeve dhe gjykimeve të çështjeve të referuara nga SHKB-ja, rekomandim i bërë edhe nga GRECO (Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës Kundër Korrupsionit).
9. Vazhdimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me Drejtorinë e Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit, duke rritur nivelin e shkëmbimit të informacionit dhe duke kryer inspektime të përbashkëta.
10. Bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe institucionet e tjera, në bërjen e sondazheve për perceptimin e publikut në lidhje me korrupsionin në Policinë e Shtetit.

SI DO TË MATET REALIZIMI I OBJEKTIVAVE TË SHKB-SË

- NËPËRMJET analizimit dhe vlerësimit të punës së kryer nga strukturat e SHKB-së në përmbushje të objektivave dhe detyrave të përcaktuara në Planin Vjetor të Punës 2012.
- NËPËRMJET vlerësimeve të shprehura në raport-progreset që lidhen punën e agjencive të zbatimit të ligjit në kuadrin e procese integruese të vendit (Ekspertë të KE-së, GRECO, DASH etj).
- NËPËRMJET treguesve statistikorë mbi ecurinë dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve të referuara nga SHKB-ja pranë prokurorive të rretheve gjyqësore, rasteve të dërguara në gjykatë dhe numrit të punonjësve të policisë të dënuar me vendim të formës së prerë.
- NËPËRMJET krahasimit të të dhënave statistikore që lidhen me marrjen, shqyrtimin e hetimin nga SHKB-ja, të ankesave të shtetasve për punonjësit e Policisë së Shtetit.
- NËPËRMJET identifikimit të masave konkrete të ndërmarra nga policia në zbatim të rekomandimeve të lëna në raportet e inspektimeve të kryera nga SHKB-ja.
- NËPËRMJET zhvillimit të mekanizmave të vetkontrollit dhe llogaridhënies, bazuar në Procedurat Standarte të Punës.
- NËPËRMJET krahasimit të të dhënave që lidhen me trajnimet e SHKB-së dhe vlerësimit individual të punës për çdo punonjës.
- NËPËRMJET krahasimit të rezultateve të sondazheve të zhvilluara nga organizmat e ndryshëm (TIA etj) mbi perceptimin e publikut për korrupsionin në Policinë e Shtetit.
- NËPËRMJET përgatitjes së raporteve analitike në lidhje me nivelin e shkallën e korrupsionit dhe të shkeljeve të tjera të kundraligjshme të evidentuar në radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit.

SI MUND TË NA KONTAKTONI

Adresa: Sheshi ëSkënderbeë, Nr.3, Tiranë.

Tel/Fax: +355 4 22 71 735 & +355 4 22 53 516

Linjë telefonike pa pagesë per ankesat **0800 90 90**

Web-site: www.moi.gov.al, ku mund të merrni informacionin e duhur në linkun për SHKB-në

E-mail: shkb@moi.gov.al, ku mund të dërgoni ankesa, informacione, etj, për shkelje të ligjit nga punonjës të Policisë së Shtetit.

Zyra e Informacionit dhe Ankesave e SHKB-së në godinën e Ministrisë së Brendshme, ku mund të depozitoni ankesën tuaj duke plotësuar formularin përkatës.

Drejtoria/Sektorët e SHKB-së në Qarqe

Mund të kontaktoni drejtpërdrejt punonjësit tanë të cilët gjenden pranë çdo strukture policore në nivel qarku, si në Drejtoritë dhe Komisaritet e Policisë.

Ankesat ndaj punonjësve të policisë mund t'ë bëni edhe pranë çdo strukture të Policisë së Shtetit.

“Korrupsioni na prek të gjithëve,
t'a luftojmë sëbashku atë”